



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 32, datë 23.06.2025

PËR MIRATIMIN PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 110, DATË 16.12.2024, “PËR MIRATIMIN E VLERËS SË SHPRONËSIMIT PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN APO ZHVLERËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT TË RIJETËZIMIT TË ZONËS ARKEOLOGJIKE “TID” Durrës, PËR ZHVILLIMIN DHE RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm për interes publik”, të ndryshuar, VKM-së nr.138, datë 23.03.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, Akt Marrëveshjes nr.7773/1prot., datë 02.10.2023, “Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Albanian-American Development Foundation dhe Ministria e Kulturës dhe Bashkia Durrës për zbatimin e projektit TID Durrësi”, si dhe të shkresës së Agjencisë Shtetërore për Shpronësim (ASHSH) nr. 107/13 prot., datë 30.5.2025, me lëndë: “Plotësim dokumentacioni”, administruar në Bashki me nr. 425/8 prot., datë 04.6.2025, në të cilën kërkohet rivlerësimi i pasurive të paluajtshme të llojit Njësi, duke u bazuar në çmimet e tregut, duke zbritur amortizimin, sipas relacionit të ardhur nga Drejtoria Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin për ndryshimin e vlerës së shpronësimit e miratuar me Vendimin nr.110, datë 16.12.2024, të Këshillit Bashkiak, për disa pasuri të paluajtshme të llojit “Njësi”,

që preken nga projekti “Rijetëzimi i Zonës Arkeologjike “TID” Durrës”, në përputhje me llogaritjet e përditësuara të kryera në bazë të pikës 3, të VKM-së nr. 138, datë 23.03.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar.

2. Vlera e re e shpronësimit, sipas rivlerësimit të kryer në përputhje me metodologjinë e VKM nr.138/2000, për objektet me funksion “Njësi”, heqjen e pasurive për të cilat ka rezultuar nga kartelat e ardhura nga ASHK Durrës se ka mbivendosje, si edhe mospërfshirjen në vlerën e shpronësimit të pasurive me pronar të pavërtetuar është 299 381 463.4 lekë (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre pikë katër), ku rezulton se vlera e shpronësimit është më e ulët se vlera e miratuar me Vendimin nr.110, datë 16.12.2024 më parë prej 467 227 937 lekë (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e dyqind e njëzetë e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë).
3. Zëvendësimin e listës së shpronësimit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr.110, datë 16.12.2024, me listën e shpronësimit që i bashkëlidhet këtij Vendimi dhe është pjesë përpërëse e këtij Vendimi.
4. Ky vendim është pjesë e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 110, datë 16.12.2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Denisa Luarasi




U shpall sot me datë 23.06.2025

[illegible]

[Handwritten signatures]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 414/prot.

Durrës, më 23.06.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.32 datë 23.06.2025 “Për miratimin për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr 110 dt 16.12.2024 “Për miratimin e vlerës së shpronësimit për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken apo zhvlerësohen nga realizimi i projektit të rijetëzimit të zonës arkeologjike “TID” Durrës, për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore”,

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

